Republika e Kosovës

Republika Kosova/Republic of Kosova

Komuna e Vitisë/Opština Vitina/Municipality of Viti

Raport i punës për periudhën Janar – dhjetor 2021

Ky raport pasqyron përmbledhjen e punës për periudhën Janar – dhjetor të vitit 2021 të Zyrtares për Barazi Gjinore dhe organeve komunale në zbatim të Planit të punës së barazisë gjinore për vitin 2021 si dhe Programit të Kosovës për Barazi Gjinore.

Në raport janë prezantuar aktivitetet, të dhënat dhe shënimet që pasqyrojnë dhe reflektojnë angazhimin dhe rezultatet e shënuara gjatë vitit 2021, në kontest të barazisë gjinore nga sektorë të ndryshëm të institucioneve komunale dhe aktivitetet e Zyrtares për Barazi Gjinore.

Raporti pasqyron implementimin e ligjeve vendore që janë në funksion barazisë gjinore, por edhe konventave ndërkombëtare të inkorporuara drejtëpërdrejtë në Kushtëtutën e Republikës së Kosovës.

Përmbledhje e aktiviteteve të kryera gjatë periudhës korrik – dhjetor 2021:

- Në nëtor të vitit 2021 u realizua projekti " Zhvillimi i qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës ekonomik rural" financuar nga Komuna e Vitisë, dhe Bashkëpunimi Asustriak për Zhvillim (ADA), ku u bë hapja e Njësisë për përpunimin e frutave dhe perimeve " Grasep" e që u punësuan 14 gra.

- U realizuan 871 vizita nga ekipet mjekësore të QKMF-së për nëna dhe fëmijë
- Në bashkëpunim me OSBE-në, u shënua në mënyrë simbolike " Dita Ndërkombëtare kundër Dhunës ndaj Gruas", ku u shpërndanë posterë dhe disa mesazhe tek qytetarët në rrjetet sociale zyrtare të Komunës

SHUPLAKA
ËSHTË DHUNË.
DHUNA ËSHTË
KRIM.
VEPRO TANI!
THIRR POLICINË E KOSOVËS
0800 19999 APO 192
OSCE
Organization for Security and Co-operation in Europe
Mission in Kosovo
UNITED AGAINST DOMESTIC VIOLENCE


Financuar nga:
THE SIGRID RAUSING TRUST
#MosHesht
"Duhet raportuar rastet e dhunës pa dallim, për një shoqëri me një jetë paqësore, është detyrë e jona."
Ibadete Hyseni
Zyrtare për Barazi Gjinore, Komuna e Vitisë
Mbështetur nga:
Zbatuar nga:

- Organizimi i takimit për planifikimin e buxhetit komunal për vitin 2022, i cili takim kishte për qëllim identifikimin e kërkesave të grave dhe inkorporimin e iniciativave të tyre në dokumentin e buxhetit komunal për vitin 2022

- Analiza gjinore dhe pergatitja e buxhetimit gjinor në kategoritë ekonomike: paga mëditje, subvensione si dhe investime kapitale, ku kemi ndërtuar rekomandimet e reja për të eliminuar pabarazitë gjinore në këto tri kategori ekonomike, e të cilat rekomandime janë inkorporuar në buxhetin e vitit 2022
- Sigurimi i të dhënave statistikore nga këto sfera:
  - administrata
  - arsimi
  - shëndetësia
  - vendimmarrje
- Dhënia e rekomandimeve në fushën e barazisë gjinore në përgjithësi për aktet normative komunale të aprovuara në KK përgjatë periudhës raportuese (harmonizimi i tyre me ligjet që janë në funksion të barazisë gjinore, gjegjësishtë në Rregulloren për Funksionimin e Këshillave të Fshatrave dhe atë për Ngarkesa, Taksa dhe Gjoba të aprovuara në vitin 2021, e të cilat rekomandime të inkorporuara në këto rregullore kanë të bëjnë me lirimin nga taksat bujqësore të grave fermere, lirimin nga taksat administrative në sektorin e gjendjes civile të grave kryefamiljare dhe fëmijëve të tyre nën moshën 18 vjeçare, lirimin nga taksat shëndetësore të grave kryefamiljare, të viktimave të dhunës dhe të trafikimit me qenie njerëzore si dhe lirimit nga pagesat e qerdheve për fëmijë të nënave vetëushqyese **(Rregulloret e aprovuara mund ti gjeni në web faqen e komunës së Vitisë)**
- Organizimi dhe mbajtja e ligjëratave në shkollat e komunës së Vitisë për parandalimin e ngacmimeve seksuale, keqpërdorimin e rrjeteve sociale, trafikimit me qenie njerëzore, parandalimit të dhunës në familje, ku përfitues direkt nga këto ligjërata ishin 525 nxënës të shkollave e mesme të ulta dhe të larta të Komunës së Vitisë. Këto ligjërata, që në numër ishin 23, janë organizuar nga ZBGJ në bashkëpunim me Policinë e Kosovës (Drejtoria për hetimin e trafikimit me qenie njerëzore si dhe Sektori për Komunitete), Psikologët si dhe Qendrën për Punë Sociale



Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Ministria e Punëve të Brendshme
Ministarstvo Unutrašnjih Poslova / Ministry of Internal Affairs
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë
Generalna Policijska Direkcija / General Police Directorate
DREJTORIA PËR HETIMIN E TRAFIKIMIT ME QENIE NJERËZORE
Trafikimi me njerëz
STOP
HUMAN
TRAFFICKING



Bullying nedir

Fuqizimi ekonomik i grave përmes ndarjes së granteve për zhvillimin e bizneseve (biznese për kultivimin e kulturave të ndryshme bujqësore). Këto subvensione janë ndarë në particim në mes të Komunës së Vitisë, Caritasit Zvicerran dhe IADK-së, ku vlera e mjeteve të ndara nga Komuna është 38.700,00€ ndërsa e organizatave 48.500€, është bërë subvensionimi i Njësisë për përpunimin e qumështit, në vlerë prej 15,600€ (të punësuara 9 gra), si dhe është bërë subvensioni i Njësisë për përpunimin e ëmbëlsirave dhe përgatitjen e tyre (të punësuara 5 gra, vlera e projektit 12,000€), si dhe agrobizneseve tjera që udhëheqen nga gratë (gjithësej 14)



- Organizimi i dy panaireve me moton " T'i njohim vlerat tona tradicionale", ku gratë ndërmarrëse në këto panaire kanë pasur mundësi t'i ekspozojnë produktet e bizneseve të tyre (Panairet janë mbajtë në muajin Prill dhe Nëntor)

- Në bashkëpunim me Qendrën Rinore, kemi organizuar dy trajnime me temë " Barazia Gjinore, një sfidë për të ardhmen" dhe "Ideja për Plan Biznese", ku pjesëmarrës në dy trajnimet ishin 30 femra. Trajnimet u financuan nga IKC



- Shënimi i muajit kundër kancerit të gjirit, ku janë mbajtur ligjërata nëpër lokalitete të Komunës së Vitisë si dhe një marsh me moton "Beso, Mos u dorëzo, lufto për jetën"

- Në bashkëpunim me OJQ " EULOC", kemi mbajtur trajnimin me temën " Promovimi i politikave dhe vendeve të punës miqësore për familjen në Komunën e Vitisë, ku ishin 20 pjesëmarrës, ndërsa projekti u financua nga RrGK

- Në bashkëpunim me OJQ " EULOC", kemi mbajtur trajnimin me temën " Analiza gjinore dhe planifikimi planifikimi i buxhetit nga përspektiva gjinore", ku pjesëmarrës ishin 20 dhe ky projekt u financua nga RrGK

- Është hapur kabineti i rrobaqepsisë në shkollën e mesme " Januz Zejnullahu", ku kjo do të jetë një mundësi e mirë për nxënësit, veçanërisht femrat që nga ky aftësim professional u krijohen mundësi të reja për punësim

Viti, 2022

Ibadete Hyseni

ZBGJ